

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.14.12.2022*

14.12.2022

Ora 9:00

RENDI I DITËS

Hedhja e shortit “Për caktimin e relatorit të kërkesës nr. 04 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për vendosje masash administrative””.

PJESËMARRJA:

- **Stafi KQZ: Y. Merkaj,**

Z. Y. Merkaj: Përshëndetje të gjithëve, sot do të zhvillojmë procedurën e shortit për kërkesën nr. 04 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve drejtuar KAS-it. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 224, dt. 7.12.2022, ka miratuar raportin e gjetjeve nga auditimi i fondeve të shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për kuvend të datës 25 prillit 2021. Në fund i është drejtuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve me propozimin për marrjen e masave administrative për 17 subjekte zgjedhore, referuar nenit 35 të Rregullores së KAS-it, e drejta e Komisionerit për të vënë në lëvizje KAS-in. Komisioneri i propozon KAS-it për marrjen e masave administrative. Procedura e shortit për caktimin e relatorit është e njejtë sipas nenit 14 të Rregullores së KAS-it. Kemi përgatitur pesë shirita letre ku në një të një prej tyre kemi vendosur kërkesën nr. 04 të Komisionerit “Për marrjen e masave” dhe katër shirita letre janë të bardhë dhe pa shënime. Këta shirita futen në gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njejtë dhe më pas në një enë transparente. Anëtarët e KAS-it kanë dhënë dakordësinë që shorti të zhvillohet pa prezencën e tyre, duke autorizuar një përfaqësues të KQZ-së që të tërheqë në emër dhe për llogari të tyre. Duke filluar nga rendi alfabetik rritës nga emri i relatorit zotit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.14.12.2022*

Elvin Lako, zotit Elvis Cefa, zotit Ilirjan Rusmali, zotit Koli Bele dhe zotit Ledio Braho. Pasi futen goglat në enën transparente, vazhdojmë me procedurën, përziejehen goglat, nga një përfaqësues i KQZ-së dhe:

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvin Lako - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvis Çefa – shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ilirjan Rusmalit - shiriti përmban kërkesa e KSHZ nr. 04 ku propozohet “marrja e masave administrative”.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Koli Bele - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ledio Braho – shiriti del i bardhë dhe pa shënime. Atëherë, në përfundim të procedurës së shortit, relator i kërkesës nr. 04 të KSHZ “Për marrjen e masave administrative”, është zoti Ilirjan Rusmali, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

